

MEHMET PASHË DERALLA MERITON QË NË QENDËR TË TETOVËS TË KETË NJË PËRMENDORE

Valdete (Hysen) Deralla-Gjinali

Të nderuar.

Ndiej kënaqësi që më jepet mundësia që sot të jem prezente në një sërë aktivitetesh që lidhen me familjen time, Deralla.

Duke qenë se jam e bija e Hysen Derallës, djalit të Mehmet Pashë Derallës, për mua kjo paraqet një kënaqësi të jashtëzakonshme. Kam jetuar për këtë ditë, më falni për lotët dhe emocionet, janë lotët e mallit për Tetovën dhe tetovarët.

U rrita në Shkodër në shtëpinë e Luigj Gurakuqit dhe u rrita me kujtimet për gjyshin dhe për përpjekjet e familjes tonë, Deralla për çështjen kombëtare.

Sot, kthehem në Tetovë dhe ky është kulmi i një momenti jashtëzakonisht të rëndësishëm për Mua, dhe për familjen time, për Derallajt.

Pasi që e dini se familja ime, Deralla, u dëbua nga Tetova kur unë isha e vogël, jo më shumë se 2 vjecare, e ruaj atë fotografi është i vetmi kujtim që e kam nga Tetova.

Me dëbimin ikën edhe kujtimet tona të cilat mbetën në Shtëpinë e familjes e cila gjendet sot në brendësi të spitalit të Tetovës, e braktisur.

Nga kujtimet e babait tim, Hysenit, që është edhe e dokumentuar me shkrim nga ana e tij. Neve, si familja na u dha kohë 2 orë që t'i bëjmë gati plackat dhe na përcollën me një kamion për në kufi me Shqipërinë. Këtu edhe fillon drama e familjes tonë, e cila sot është e shpërndarë në : Tiranë, Shkodër, në Dibër, në Perëndim dhe më së paku është prezente ne Tetovë. Kthehem sot kryelartë bashkë, për të manifestuar unitetin e

familjes Deralla, për të manifestuar bashkimin e vuajtjeve tona, për të manifestuar dashurinë që kemi për Shqipërinë, për Tetovën , për shqiptarët.

Edhe pse nuk jam qytetare e Tetovës, pasi që emrat tonë janë fshirë nga ditarët e regjistrave civile në Maqedoni, unë i kam ruajtur me shumë kujdes dokumentet dhe mund të dëshmoj në cdo kohë deri në Gjykatën e Strasburgut për vuajtjet e familjes time, për Derallët e dëbuar padrejtësisht nga Tetova.

Në kujtimet e mia kujtoj sot dhe i ruaj letrat dhe korrespondencën me axhën Tim të shtrenjtin Gajur Deralla, i cili me shumë kujdes më shkruante dhe i shkruaja deri në vdekjen e tij fizike në SHBA. Edhe këto dëshmi i kam ruajtur me kujdes të jashtëzakonshëm, si një dëshmi të ekzistencës së Derallajve, për t'u shkruar si duhet historia shqiptare, dhe për të cuar në vend amanetin e familjes, amanetin e babës Hysenit, amanetin e axhës Gajurit. Të cilat dokumente ia lë amanet profesorit Arsim Sinani t'i arkivojë po të njejtat.

Sot, kam shumë emocione kur kthehem në vendlindjen time në Tetovë, aty ku u linda dhe aty ku mu mohua e drejta të rritem. Sot dua të përcjell disa mesazhe simbolike para jush:

Mehmet Pashë Deralla meriton që në Qendër të Tetovës të ketë një përmendore si një simbol të përkushtimit të tij për shqiptarët;

Në marrëveshje me shtetin shqiptar në Tiranë t'i vendoset shtatorja. do ishte një dëshirë e familjes pasi kontributi I tij është i pamohueshëm në ngritjen e shtetit modern shqiptar

Më lejoni që në fund tju flm për këtë mikpritje që e gjejmë sot në Tetovë.